


**DRAFTI I**  
**RAPORTIT TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE**  
**MJEDIS**  
**TE AKTIVITETIT**  
**“Riparim i mjeteve te lundrimit”**



**Subjekti:** “C.N.Adr” sh.p.k

**Vendndodhja:** Durres Durres DURRES Rruga Rinia, Nr Pasurie 8/28, Zona Kadastrale 3184

**Pergatiti materialin :** “Eko- Studio- Projekt” sh.p.k



## PERMBAJTJA

- ✚ Hyrje
- ✚ Baza ligjore
- ✚ Metodika e vleresimit te mjedisit
- ✚ Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT
2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI
3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS
4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE
5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

## **HYRJE**

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajtuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

### **“Riparim i mjeteve te lundrimit”**

## **BAZA LIGJORE**

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431,date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 10 266 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt*

*te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*

- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013 ” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*

## **1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**

### **➤ Profili i propozuesit**

Subjekti “ C.N.Adr ” sh.p.k eshte regjistruar prane QKR me numer NIPT-i L72227035R me administrator Znj. Nertila Çeta me adrese te selise qendrore ne Tirane Tirane TIRANE Rruga Themistokli Gërmenji, pallati Ambasador 1, kati I-rë .Me pergatitjen e dokumentacionit perkates subjekti kerkon te pajiset me Leje Mjedisore tipi B .

### **Qellimi i projektit**

#### **Riparim i mjeteve te lundrimit.**

Duam te theksojme se ne shume raste anijet e vjetra ne gjendje te mjerueshme jane pjese e aksidenteve te ndrushme por edhe prehe e kushteve te veshtira atmosferike dhe ne shume raste keto mjete lundrimi perfundojne ne fund te detit duke ndotur, shendruar dhe duke demtuar fundin e detit dhe mjedisin detar.

Nisur nga filozofija jone per evitimin e ketyre incidenteve me pasoja ne impaktin ne mjedis Ne punojme per riprojektimin, pastrimin regjenerimin dhe me pas ristrukturimin e ketyre mjeteve duke prodhuar mjete me eficence te larte duke i dhene atyre perseri jete dhe duke ritur sigurine e tyre por edhe konfortin dhe duke ulur impaktin ne mjedis.

### **Vendndodhja**

Subjekti do e ushtroje aktivitetin e tij ne Durres Durres DURRES Rruga Rinia, Nr Pasurie 8/28, Zona Kadastrale 3184

### **SHËRBIMI DHE ASISTENCA PER MJETET E LUNDRIMIT PER QELLIME TURISTIKE**

Si pjesë e një kompanie te madhe, CNA Yachts do të ofrojë sherbime profesionale dhe ndihmë të privilegjuar për pronarët e anijeve te cilat kane nevojte te ristrukturohen. Në marrëveshje me partnerët e sajë dhe prodhuesit e pajisjeve dhe pjeseve te nderrimit origjinale kryhet rigjenerimi, ristrukturimi dhe krijimi i nje konforti te ri per mjetet te cilat punohet.

Misioni i Kompanise eshte:

Jahte CNA është e përkushtuar për të çiftëzuar qasjen më të fundit të qëndrueshmërisë mjedisore me kuptimin më tradicionale të besueshmërisë dhe vlefshmërisë së lundrimit.

Sipërmarrësit, projektuesit dhe inxhinierët italianë, të cilët ndajnë të njëjtin pasion për cilësinë, inovacionin dhe elegancën tradicionale, japin kontributin dhe eksperiencën e tyre në cilësinë dhe garancinë e punëve që do të kryhen në kantierin e riparimit të mjeteve të lundrimit në Porto Romano të Durrësit.

Objektivi i Jahte CNA është të respektojmë detin dhe mjedisin përreth me anë të përdorimit të teknologjive të thjeshta me një impakt të ulët me një ndikim sa më minimal me mjedis, me një filozofi inovative në përdorimi e gjerë të materialeve të riciklueshme.

Duam të theksojmë se në shumë raste anijet e vjetra në gjendje të mjerueshme janë pjesë e aksidenteve të ndrueshme por edhe prehe e kushteve të vështira atmosferike dhe në shumë raste këto mjete lundrimi përfundojnë në fund të detit duke ndotur, shendruar dhe duke demtuar fundin e detit dhe mjedisin detar.

Nisur nga filozofija jonë për evitimin e këtyre incidenteve me pasoja në impaktin në mjedis Ne punojmë për riprojektimin, pastrimin regjenerimin dhe me pas ristrukturimin e këtyre mjeteve duke prodhuar mjete me efikasitet të lartë duke i dhënë atyre perseri jetë dhe duke ritur sigurinë e tyre por edhe konfortin dhe duke ulur impaktin në mjedis.

Proceset kryesore për rigjenerimin, restaurimin dhe ristrukturimin e mjeteve lundruese janë:

- *Pastrimi dhe rigjenerimi i sipërfaqes së jashtme dhe të brendshme.*
- *Lyerja dhe restaurimi i sipërfaqeve të jashtme dhe të brendshme.*
- *Riparimi dhe restaurimi i nyjeve dhe paisjeve mekanike dhe hidraulike.*
- *Riparimi dhe restaurimi i sistemeve elektrike dhe elektronike.*
- *Shtimi ose përmirësimi i sistemeve software e hardware.*
- *Shtim ose zëvendësim i paisjeve, për shembull, zëvendësimi i pajisjes së vjetër me kuvertë me pajisje të reja ose të kryqëzuara.*
- *Përshtatje: për shembull përshtatjen e një jahti për nevojat dhe dëshirat e pronarit.*
- *Modernizimi: për shembull modernizimi i një jahti të vjetër me një stil modern, teknologji dhe sisteme.*
- *Rimëkëmbjes: për shembull restaurimi i një anije të vjetër prej druri për ruajtje.*

Për anijet e vjetra ose të demtuara është e rëndësishme të kryhen punime për të sjellë në një status normal dhe të pranueshëm. Për këto "Rishikimi dhe ose rikonfigurimi / restaurimi i anijeve që përfshin riparimin, ndreqjen, restaurimin, rinovimin, riparimin e pjesshem ose të plote dhe ristrukturimin e anijeve, anijeve dhe jahteve".


Per te realizuar kete objektiv po pershkruajme proceset e pergjithshme te punes :

- I. Evidentimi i mjeteve te lundrimit te cilat mund te ristrukturohen dhe te shendrohen ne mjete me nje destinacion te ri duke ju dhene atyre nje jete gjatesi dhe konfort per kete destinacion.
- II. Me nje ekip te specializuar Arkitektësh te Marinës Detare dhe Dizajneve të Brendshme te specializuar ne kete fushe punohet per hartimin e projekteve te dedikuar, me qëllim të nxjerrjes dhe evidentimit te potencialeve te ketyre mjeteve dhe ne shenderimin e tyre ne mjete me nje destinacion te ri si jahte luksoze per perdorime turistike, duke respektuar vlerat dhe karakteristikat e ketyre mjeteve.
- III. Gjetja e menyres me eficente, rast pas rasti per te kryer transportin e tyre ne kantierin e riparimit ne Porto Romano te Duresit.
- IV. Nxjerja ne breg ne nje pataforme betoni dhe ngritja e tyre ne struktura te posacme dhe vendosja e nje sistemi skelerije qe do te siguroje:
  - Impakt minimal gjate kryerjes se punimeve ne anije.
  - Stabilitet dhe siguri te plote gjate punes per ristrukturimin e tyre.
  - Mundesine dhe facilitetin per nje akses ne te gjith siperfaqen e jashtme te anijes.
- V. Krijimi i kushteve optimale per te kryer evidentimin e nderhyrjeve te domosdoshme per rigjenerimin e siperfaqeve te brendeshme dhe te jashme.
- VI. Organizimi i punes per pastrimin e te gjith siperqeve te brendeshme dhe te jashtme me ane te paisjeve te levizeshm zmeriluese.
- VII. Pastrimi i thelle i siperfaqeve te jashtme dhe te brendeshme me paisje portative qe perdorin rere kuarci per nje pastrim te thelle te gjith siperfaqeve te jashtme dhe te brendeshme.
- VIII. Evidentim i ndehyrjeve te mundeshme ne siperfaqet e jashteme dhe te brendeshme te skafit dhe percaktimi i lloit te nderhyrjeve qe do te kryhen dhe menyra dhe teknologjia per te realizuar nderhyrje me efice te lart por me impakt minimal.
- IX. Trajtimi i siperfaqeve me bojta speciale dhe qe garantojne nje jetegjatesi te skafit edhe ne kushtet ekstreme te motit.
- X. Pasi kryhet regjenerimi i skafit jashte dhe brenda fillon puna per kompletimin e anijes sipas projektit me paisjet dhe agregatet e domosdoshem per lundrim duke rritur standartet dhe konfortit ne keto mjete.

Paisjet qe montohen ne skafin e ristrukturuar jane te rigjeneruara dhe plotesojne standartet nautike per nje lundrim te qete, konfort dhe te sigurte. Ne rastin e pa mundesise se rikuperimit te ketyre paisjeve vendosen dhe montohen te reja.

- XI. Kryhet riparimi dhe regjenerimi i te gjith sisteve hidraulike duke kryer edhe rritjen e eficences sipas rasteve.
- XII. Montimi i motorrit dhe pjeseve mekanike kryhet na specialist te ketije sektori dhe perdoren motore te regjeneruar dhe eficente per aktivitetin e ri qe do te kryej mjete i lunderimit.

*Ne vijim nje model motori qe perdoret:*




- XIII. Per te ritur konfortin, ne perputhje me dezainin e percaktuar nga arkitektet kryhen montimet e ruifiniturave te ndryshme duke bere te mundur realizimin e nje konforti cilesor dhe duke i ridhene jete ketyre mjeteve.
- XIV. Ne perputhje me destinacionin e ri te ketyre mjeteve kryhet edhe paisja e tyre me siste me te reja teknologjike qe perdoren per te ritur facilitetet dhe sigurine ne navigim duke perdorur teknologji inovative ne sistemet elektrike, elektronike si dhe ne perdorimin e software e hardware inovativ te gjeneratave te fundit.
- XV. Duke qene se destinacioni i ri i ketyre anijeve te shenderuara ne Jahte turistik, kerkon nje konfort te larte montohen edhe sistem argëtimi te ndryshem sipas nevojës se klienteve.
- XVI. Operacini i fundit eshte kontrolli dhe garantimi i funksionimit harmonik te gjithe paisjeve, agregateve dhe sistemeve per te garantuar siguri, cilesi si dhe konfort te larte ne navigim.

Per te pershkruar aktivitetin po tregojme historine e një rimorkiatori i nisur në vitin 1962 si një rimorkiator akulli për Marinën Polake, qe shërbeu në Detin Baltik dhe në Detin e Veriut deri në vitin 1987 kur u shit në një kompani maltase. Nja dy vjet më vonë u ankorua në Holandë, ku perdorej si pastrues akulli jashtë kanaleve, derisa një sy i mprehtë e kapi dhe vleresoi gjendjen e keqe dhe degrduese ne te cilin ishte ky rimorkiator dhe vendosi ta sjellë atë edhe nje here në jetë duke e ristrukturuar.

Per Jahte CNA eshte projekti Projekti Hybrid 1962 me te cilin desherojme te tregojem aktivitetin e sipermarrjes tone per te vleresuar punen per jetezimin e anijeve te vjetra si pjese e filozofise tone per te reduktuar impaktin dhe per te mbajtu sa me te paster detin dhe mjedisin qe na rrethon.

## 2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

Durresi mund të krahasohet me qytetet me të mëdhenj të Mesdheut antik dhe mesjetar. Qyteti Epidamn - Dyrrah u ndertua nga Iliret Taulante, dallendyshasit në shekujt XIII-XI p.K. Në kushtet e një klime mesdhetare, zona me e pershtatshme për banim ishte ajo e lumit Erzen si dhe Ultesira Perendimore përreth saj. Në bregdetin e Gjirit të Durresit u vendos qendra e parë apo Limani me emrin Dyrrah. Sipas autoreve antike, ky qytet u themelua nga dy mbretër me origjinë ilire të quajtur Dyrrah dhe Epidamn. Në kohën e Perandorit Anastas i I (491-519) dhe Justiniani I [527-565), qyteti pësoi transformime të ndjeshme në strukturën urbane duke marrë tiparet e një qyteti tipik bizantino-kristian. Në shek. XI-XV, Shteti Shqiptar njihet me emrin Shteti i Arbrit. Ky shtet, kulmin e tij e arriti në periudhën e mbretërimit të Gjergj Kastriotit. Sipas kronikave Osmane të shek. XVI, Durresi apo sic e çilesojnë ata "Kostandinopoja e Dytë", u pushtua nga turqit më 13 Gusht 1501. Vetëm në shek XVII, qyteti filloi të rimarrë veten duke bërë qender të tregtisë tranzite dhe skela kryesore e Shqipërisë së Mesme. Më 26 Nëntor në Durres ngrihet flamuri i Pavarësisë, nga një grup patriotësh të kryesuar nga atdhetari Ismail Qemali. Sundimit turk i kishte ardhur fundi, por duket se qytetin e lakmonin invazione të tjera: pushtimi serb (1913), ai austro-hungarez (1916) dhe pushtimi italian (1918). Gjate viteve të monarkisë shqiptare (1924-1939) Durresi fitoi një frymë të re dhe qytetaria fisnike durrsake e bëri qytetin e vetë model të zhvillimit ekonomik kapitalist. Më 7 Prill 1939 qyteti dhe rrethinat e tij u pushtuan nga trupat e ushtrisë italiane dhe gjermane dhe më 14 Nëntor 1944, Durresi u çlirua. Periudhës së sistemit socialist (1945-1990), i perkasin investimet në disa degë të industrisë, kolektivizimi i bujqësisë, masivizimi i arsimit, ngritja e një sërë objektësh social-kulturore. Në fillim të viteve '90 zënë fill normat e para të sistemit demokratik me shumë probleme për fazën e tranzicionit, por me perspektivë për të ardhmen. Sistemi i ri dhe reformat ekonomike që u zbatuan në Shqipëri dhe në Durres pas vitit 1990, sollen transformime të ndjeshme në jetën ekonomike. Kultura dhe etnografia Durresi është një qytet me kulturë të hershme, për vetë origjinën e tij të lashtë.





Durrësi është qyteti i dytë më i madh në Shqipëri. Qyteti ka mbi 200,000 banorë dhe njëkohësisht është qendra e prefekturës dhe qarkut të Durrësit. Është një nga qytetet më të lashtë dhe më të rëndësishëm ekonomikë të Shqipërisë. Durrësi është i vendosur në bregdetin qëndror shqiptar, rreth 33 km (21 mi), në perëndim të kryeqytetit Tiranë. Ai ndodhet në një nga pikat më të ngushta të Detit Adriatik, përballë porteve italiane të Barit (300 km/186 mi larg) dhe Brindisit (200 km/124 mi larg). Qyteti i Durrësit është i populluar nga rreth 202.000 banorë (me të dhënat e vitit 2009). Në qytetin e Durrësit ndodhet universiteti më i ri publik në Shqipëri i quajtur Aleksandër Moisiu. Durrësi mbahet mend edhe si kryeqyteti i shtetit shqiptar nga 7 marsi 1914 deri më 11 shkurt 1920. Durrësi u bë kryeqytet i Mbretërisë së Shqipërisë nga Princ Vidi kur ai zbarkoi më 7 mars 1914 e deri në vendimin e Kongresit të Lushnjës të datës 11 shkurt 1920 për shpalljen e Tiranës si kryeqytetin e ri të shtetit shqiptar.

### **Kushtet klimaterike**

Kjo zone ben pjese ne nenazonen qendrore te zones klimaterike mesdhetare . Dimri eshte i bute dhe me lageshti ndersa vera eshte e nxehte dhe e thate . Kjo zone ka mbi 2500 ore ndricim dielli ne vit . Muaji me ndricim me te gjate eshte Korriku me 350 ore dhe muaji me ndricim me te shkurter eshte Dhjetori me 108 ore . Temperatura mesatare e ajrit eshte afersisht 13.8 grade celsius ndersa me te ulet e ka muaji Janar me afersisht mesatare prej 5.7 °C. Ne pergjithesi ndryshimet mujore te temperaturave jane graduale dhe jane me te medha gjate kohes se ndryshimit te te regjimit te stineve . Keto fenomene ndodhin ne periudhat Mars-Prill dhe ne Tetor – Nentor kur kemi perkatesisht kalimin nga regjimi dimeror ne ate pranveror dhe nga vjeshtor ne dimeror . Vlera maksimale e reshjeve te rregjistruara ne 24 ore ka arritur shifren prej 185 mm pa konsideruar matjet e koheve te fundit . Reshjet e bores ne kete zone jane shume te rralla dhe bore mund te kete 2-3 dite ne vit sipas statistikave te fundit me nje trashesi qe nuk i kalon 5 cm . Vlera maksimale e temperatures se ajrit ne kete zone me nje siguri prej 50% eshte rreth 37 °C dhe temperatura minimale rreth 4 °C . Mesatarja e reshjeve vjetore sipas statistikave eshte 1.800 mm/vit e shperndare ne menyre te crregullt ne kohe dhe sasisa me e madhe eshte ne periudhat Tetor – Maj me nje sasi rreth 70% duke rregjistruar si muajin me te lagesht muajin Nentor . Muaji me i thate rezulton muaji Korrik por ka ndryshime nga viti ne vit per shkak te ndryshimeve globale. Si rrjedhim ky territor ne te cilin kerkohet te zhvillohet ky aktivitet eshte i favorshem per kete zhvillimin e kesaj veprimtarie . Ererat kryesore jane ne drejtimet juglindje - veriperendim dhe verilindje – jugpere ndim por nuk jane te forta . Nder ererat kryesore ne kete zone mund te permendim : ≈ murlanin i cili vjen nga veri-lindja eshte i ndjeshem vecanerisht ne peridhen e dimrit ,ka shpejtesi te madhe dhe karakterizohet nga nje mot i ftohte . ≈ shirokun e cila vjen nga juglindja vecanerisht ne periudhen e vjeshtes dhe fillim dimri, eshte e ftohte dhe karakterizohet nga mot me lageshtira , me shira te shumte . puhia e cila vjen nga veriperendimi , eshte e ngrohte dhe ndihmon ne nje klime te nxehte

### **Ekosistemet , flora dhe fauna**

Ekologjia eshte shkenca qe studion ligjet e marredhenieve te ndersjellta ndermjet gjallesave dhe mjedisit ku ato jetojne. • Faktoret ekologjikë (elementë të mjedisit) – Abiotikë (fizikë dhe kimikë) – Biotikë • Faktorët Antropogjen (ndikimi i njeriut) • Ekosistem (sistem ekologjik) – çdo bashkesi e formuar nga gjallesat dhe mjedisi abiotik, qe kane ndermjet tyre bashkeveprim e lidhje te ndersjellta. • Biocenoze – teresia individëve të llojeve të ndryshme që bëjnë pjesë në ekosistem. • Biotop – mjedisi ku jeton Biocenoza. • Rrjetat ushqimore –

zinxhire ushqimorë paralelë ose të gërshetuarnë biocenozat natyrore. Zinxhirët ushqimorë nga ana e tyre përfaqësojnë njeseri gjallesash (tri nivele trofike: prodhues, konsumator, dekompozues), ku çdo organizem (hallkë) shërben si ushqim për hallkën pasardhëse. Larmia biologjike paraqitet e mirë në disa vende dhe me bimesi drunore të lartë të ruajtur nga investimet e viteve me parë. Duke qenë në zone banimi ka disa lloj pemesh frutore dhe jo jofrutore të kultivuar në vite por që i kanë mbjelle vetë pronarët në disa objekte. Në këto sipërfaqe nuk ka bime endemike apo specie bimore të mbrojtura nga Konventat Nderkombetare në të cilat vendi ynë aderon. Në këto territore ka një faunë mjaft të varfër. Nder gjatë kryesisht janë breshërit e vegjel. Në këto zone kryesisht për shkak të lartësisë së vogël të bimëve vërehen të ulen harabele edhe disa lloj migratorësh, trumçakët, kryesartezat, kumrite etj. Karakteristika kryesore e zonës së marrë në shqyrtim është se në një territor shumë të vogël takohen lloje të ndryshme ekosistemesh duke përfshirë ato malore, lumore, të ujërave të ëmbëla (e rezervuarë) si dhe ekosisteme bujqësore ose agro ekosisteme. Vegjetacioni tokësor në këtë zonë i përket kryesisht karakterit të Europës Qendrore Kontinentale me prani të pak elementëve mesdhetarë. Formacionet bimore të tërësisë tokësore shprehin një larmi formash, duke u zhvilluar në mjediset e ulta afër ujembledhësve dhe Perrenjve ku sistemet ekulturave bujqësore dominojnë, në rajonet me lartësi të mesme e të madhe, e deri në zonat e kullotave alpine. Në fushat e ulëta dhe kodrat, janë përshkruar një larmi formash barishtore si më poshtë vijon: vegjetacioni i barishteve të këqija ndaj kulturave bujqësore, vegjetacioni nitrofil dhe vegjetacioni anash rrugor, vegjetacioni amofil, i kullotave të ulta e kodrinave, vegjetacioni i livadheve malore, dhe vegjetacioni i sistemeve pyjore. Duke u mbështetur në vëzhgimet e deritanishme, ekosistemet natyrore të kësaj zone përbëhen nga një tërësi nënhabitatesh siato të sistemeve të përhershme ujore, të kanaleve kullues e ujitës, ekosistemeve të rezervuareve, bankinave të sistemeve rrjedhëse ujore etj. Bimët e rralla Ekosistemet tokësore të zonës i përkasin nën ndarjes ballkanike të zonës së vegjetacionit Sub-Mesdhetar.

### **Popullsia**

Qyteti i Durrësit ka një popullsi rreth 200.000 mijë numër i cili ndryshon në mënyrë të vazhdueshme për shkak të ardhjeve dhe levizjeve nga vende të tjera pothuaj nga të gjitha trevat. Aktiviteti kryesor në këto zone është turizmi për shkak të karakterit të qytetit bregdetar.

### **Sizmiciteti**

Rajoni ku shtrihet territori i Bashkisë së Durrësit ndodhet në pjesën perëndimore të Ulëtirës së Tiranës. Ajo ndodhet në një distancë mesatare prej 40 km nga qyteti i Tiranës dhe si e tillë përfshihet kryesisht në territoret e prekura nga po të njëjtët tërmete që kanë prekur këto qytet dhe zonat përreth tyre. Zona Joniko-Adriatike e shkëputjeve mbi hipëse është zona më e gjatë dhe me aktivitetin sizmik më të fuqishëm të vëndit tone prej së cilës janë gjeneruar edhe tërmetet më të mëdhenj që kanë prekur vëndin tone. Ajo ndiqet për disa qindra km përgjatë bregdetit Adriatik e Jonian edhe jashtë territorit tonë dhe nëpërmjet dy shkëputjeve tërthoreve, Shkodër-Pejë dhe Vlorë-Tepelenë, ndahet në tre segmente si: a) Segmenti verior me shtrirje PVP i karakterizuar nga shkëputje para-Pliocenike të tipit mbi hipëse të zones Kruja; ndiqet mbi 200 km nga Lezhanë Ulqin e më tej përgjatë bregdetit dhe është aktive edhe në ditët tona. b) Segmenti jugor me shtrirje VP që ndiqet për mbi 250 km, nga Vlora në Konispol e më tej në Greqi, përgjatë bregdetit Jonian dhe karakterizohet nga shkëputje para-

Pliocenike mbihypëse të zones Jonike. Segmenti qëndror me shtrirje V deri VP që përbëhet nga shkëputje pas-Pliocenike mbihy pëse aktive të Ultësirës Pranadriatike dhe ndiqet përreth 130 km nga Vlora deri në Lezhë. Ky segment është aktiv edhe në ditët e sotme. Sipas hartës së tërmeteve maksimale të pritshëm në këtë zonë mund të gjenerohen tërmete me magnitudo maksimale të pritshme deri  $M_{max} = 6.5-6.9$  Nga ana gjeologjike rajoni i Durrësit përfshihet kryesisht në zonën e jashtme tektonike Jonike që përbën edhe ballin orogjenik në zonën e kolizionit Adriatik. Zona e Durrësit Zona e Durrës përfaqëson një kurrizore që kufizohet në lindje me zonën tektonike të Kraste- Cukalit ndërsa në perëndim me zonën Jonike dhe zonën e Adriatikut Jugor. Gjate gjithë kufirit tektonik lindor, vërehet branisje e flisheve dhe rralle here edhe gelqeroreve globotrunkanike të nënzones së Krastes mbi fliшин oligocenik të zones Kruja. Kontakti me zonën e Adriatikut Jugor dhe zonën Jonike nuk është kudo i qartë dhe i prere. Ky kufi është i diskutueshëm sidomos për pjesën jugore. Zona tektonike e Durrësit, në të gjitha studimet e realizuara deri tani, është trajtuar si një zonë e vetme nga Leskoviku në jug, deri në Shkoder në veri. Disa studiues (Misha, etj. 1982, etj.) mbështetur në praninë e foraminifereve planktonike në depozitimet pelagjike të Kretakut në antiklinën e Melesinit, e kanë trajtuar këto të fundit si njësi të zones Jonike. Studimi tematik për deshifrimin biostratigrafik të depozitimeve karbonatike të zones Durrës (Koroveshi, etj. 1999) solli të dhëna të rëndësishme biostratigrafike të cilat tregojnë për ndryshime të theksura të facies karbonatike nga veriu në jug. Në pjesën veriore, në të gjitha prerjet stratigrafike të kryera në depozitimet karbonatike rezultojnë vetëm foraminifere bentosike, që janë tipike për facien neritike. Këtu në përjashtim strukturave me veriore, ajo e Ishmit, ku nga analizat e kryera në kampionet e marra në pusin Ish.1. ka rezultuar faunë e perziere, e cila interpretohet si kalimtare për në zonën Jonike (Nakuçi etj. 2001). Në jug, në antiklinën e Tomorrit, në depozitimet e Kretakut të sipërme janë takuar foraminifere planktonike krahas atyre bentosike. Duke analizuar kohën e rudhaformimit, facien e depozitimeve karbonatike dhe stilin tektonik vëhet re qartë një ndryshim i dukshëm ndërmjet strukturave në rajonet nga Elbasani e më në veri nga ato më në jug. Në veri të Elbasanit strukturat janë lineare, kryesisht izoklinale, me facie neritike, të karakterizuara nga praninë e foraminifereve bentosike, me moshe të orogjenezës në fund të Oligocenit të hershëm. Ndërsa strukturat në pjesën jugore janë të natyrës antiklinale ose brahiantiklinale me facie të perziere, me fenomene paleogeografike dhe me moshe më të vonshme të orogjenezës (në fund të Oligocenit të mesëm). Ky dallim esencial interpretohet si efekt i ndikimit të terthores Vlore – Elbasan - Diber, në jug të së cilës ndertimi tektonik kondicionohet dhe nga praninë e prishjeve të tjera terthore dytesore dhe tektonikes kriporë. Nisur nga veçoritë e mesiperme, për të evidentuar më mirë ndertimin tektonik të kësaj zone, përshkrimin tektonik të saj do ta bëjmë sipas dy nënzonave tektonike të kondicionuar nga thyerja e thellë tektonike e lindur qysh në kohën e riftezimit të Albanideve të Jashteme.

### **3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**

Çdo aktivitet që zhvillohet shoqërohet me pasoja dhe ndikime në mjedis, që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria jone ka zgjedhur për të zhvilluar. Megjithatë e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve, forma e shfaqjes së tyre dhe me analitikisht ndikimet e çdo operacioni të kryer.

#### **Mbetjet e ngurta**

Mbetjet që do të krijohen nga stafi do të mblihen në vendet e caktuara nga shoqëria për të tërhequr me pas nga pushteti vendor. Përsa i përket mbetjeve të cilat do të gjenerohen nga aktiviteti ato do të jenë mbetje që do të gjenerohen nga proceset e punës si më poshtë:

- *Mbetje nga pastrimi dhe rigjnerimi i sipërfaqes së jashtme dhe të brendshme.*
- *Mbetje nga lysterja dhe restaurimi i sipërfaqeve të jashtme dhe të brendshme.*
- *Mbetje nga riparimi i pajisjeve mekanike dhe hidraulike.*
- *Mbetje nga pajisjet elektrike dhe elektronike.*
- *Shtim ose zëvendësim i pajisjeve, për shembull, zëvendësimi i pajisjes së vjetër me kuvertë me pajisje të reja ose të kryqëzuara.*

Të gjitha mbetjet e gjeneruara nga proceset e mesipërme subjekti duhet të menaxhojë me subjekte të cilat janë të pajisur me licencë të tipit III.2.B për menaxhimin e tyre.

#### **Ndikimet mbi popullsinë**

Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk ka ndikime negative mbi popullsinë përreth, përveçse zhvillimi i këtij aktiviteti do të sjellë punësimin e disa baroreve të zonës duke kontribuar sadopak në rritjen e mirëqenies në zonë këtë zonë.

#### **Ndikimet në cilësinë e ajrit**

Përsa i përket shkarkimeve në ajër nga zhvillimi i aktivitetit nuk emetohen gaze të demshme në atmosferë për mjedisin apo banorët e zonës përreth. Referuar natyrës së procesit nuk kemi sasi gazesh të shkarkuar në atmosferë.

#### **Ndikimet në ujë**

Uji nuk do të perdoret në procesin teknologjik, përsa i përket ujërave të gjeneruar nga stafi ato do të shkarkojnë në sistemin e kanalizimeve të zonës.

### **Ndikimet nga zhurmat**

Zhurmat shkaktohen nga mjetet te cilat do te sjellin lendet e para per riparimin e mjeteve lundruese , si dhe gjate procesit te pune. Keto zhurma jane normale per zhvillimin e ketij lloj aktiviteti.

### **1. MASAT PER ELEMENIMIN / ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**

#### **Masat per menaxhimin e mbetjeve te ngurta**

Mbetjet qe do te krijohen nga stafi do te mblidhen ne vendet e caktuara nga shoqeria per tu terhequr me pas nga pushteti vendor .Persa i perket mbetjeve te cilat do te gjenerohen nga aktiviteti ato do te jene mbetje qe do te gjenerohen nga proceset e punes si me poshte:

- *Mbetje nga pastrimi dhe rigjnerimi i siperfaqes se jashtme dhe te brendeshme.*
- *Mbetje nga lysterja dhe restaurimi i siperfaqeve te jashtme dhe te brendeshme.*
- *Mbetje nga riparimi i paisjeve mekanike dhe hidraulike.*
- *Mbetje nga pajisjet elektrike dhe elektronike.*
- *Shtim ose zëvendësim i paisjeve, për shembull, zëvendësimi i pajisjes së vjetër me kuvertë me pajisje të reja ose të kryqëzuara.*

Te gjitha mbetjet e gjeneruara nga proceset e mesiperme subjekti duhet ti menaxhoje me subjekte te cilat jane te pajisur me licenc te tipit III.2.B per menaxhimin e tyre.

#### **Masat per ndikimet ne cilesine e ajrit**

Persa i perket shkarkimeve ne ajer nga zhvillimi i aktivitetit nuk emetohen gaze te demshem ne atmosfere per mjedisin apo banoret e zones perreth. Referuar natyres se procesit nuk kemi sasi gazesh te shkarkuar ne atmosphere. Punonjesit do te pajisjen me mjete mbrojtese si maska kunder gjate smerilimit dhe lysterjes

#### **Masat per ndikimet ne uje**

Uji nuk do te perdoret ne procesin teknologjik,persa i perket ujrave te gjeneruar nga stafi ato do te shkarkojne ne sistemin e kanalizimeve te zones.

### **Masat per ndikimet nga zhurmat**

Zhurmat shkaktohen nga mjetet te cilat do te sjellin lendet e para per riparimin e mjeteve lundruese , si dhe gjate procesit te pune. Keto zhurma jane normale per zhvillimin e ketij lloj aktiviteti.

#### **Rastet aksidentale**

Do merren masat per parandalimin e tyre, pajisjet ne kantier do kontrollohen vazhdimisht per gjendjen teknike te tyre. Shoqeria siguron se do kete nderhyrje te menjehershme nese do te kete ndikime negative ne mjedis.

#### **Plani i menaxhimit**

Zbatimi i projektit teknologjik kërkon një menaxhim të saktë të të gjitha halkave kryesore dhe ndihmëse.

Në menaxhimin e këtij projekti ndikojnë shumë faktorë ndër më kryesorët mund të rendisim:

1. Kontrollin e aparaturave te Procesit te punes.
2. Respektimin e teknologjise, raportet e lendeve te para qe futen ne proces.
3. Hedhjen e pakontrolluar e mbetjeve te ngurta dhe te lengeta ne ambient.
4. Rregullat e sigurimit teknik ne pune dhe mbrojtjes nga zjarri

Me qene se kemi te bejme me objekt industrial te riparimit te mjeteve lundruese, kerkohet nje monitorim i plote i parametrave teknik te projektuar.

Ky investim eshte aktivitet me perfitime ekonomike dhe eshte projektuar dhe ndertuar me teknologji te perparuar qe ndikimet negative ne mjedis te jene minimale.

Procesii punes mbahet nen kontroll gjate gjithë kohes qe eshte ne pune nga personeli inxhiniero-teknik.

#### **Zhurmat**

Objekti eshte larg qendrave te banuara dhe do punohet vetem ne nderresen e pare e ne keto rrethana intensiteti i zhurmave te krijuara nga mjeteve nuk perben problem shqetesues per zonen perreth por as per punonjesit brenda impiantit, sepse eshte brenda normave te lejuara per mjedisë pune.

Megjithate aktiviteti ka marre masat perkatese:

- Makinerite duhet te pershtaten sipas modeleve perkatese Makinerite qe do te perdoren do te mbyllen here pas here ne kohen kur nuk do te nevojiten per shfrytezim.

#### **✚ Mbrojtja nga aksidentet dhe kushtet ne pune**

##### ➤ **Detyrat e subjektit qe do te zhvilloje aktivitetin:**

- Do te punesohen punonjes qe e kane mbushur moshen per pune dhe specialist te profesioneve qe kerkohen.
- Do te punesohen punonjes qe kane eksperience te gjate ne profesion.
- Punonjesit para fillimit te punes dhe gjate saj ne menyre periodike do te instruktohen per rreziqet ne pune dhe masat e menytrat per parandalimin e tyre.
- Punonjesit do te pajisjen me mjete mbrojtese si maska kunder gjate smerilimit dhe lyerjes.
- Do te instruktohen punonjesit ne menyre periodike.

##### ➤ **Detyrat e punonjesve:**

- Te mos perdore pije alkoolike para fillimit te punes dhe gjate kohes se punes.
- Te kontrolloje gjendjen teknike te pajisjeve ne perdorim para fillimit te punes dhe pasi konstaton gjendjen e rregullt te tyre fillon punen.
- Kur konstaton difekt dhe nuk eshte ne gjendje ta eliminoje ndalon punen dhe ve ne dijeni pergjegjesin me te afert.
- Te perdore mjetet individuale te mbrojtjes gjate punes.

Per "EKO - STUDIO - PROJEKT" sh.p.k

Ing. Xhevair DERMYSHI

